

LEGAL DEFINITIONS

Përditësimi i fundit 11 Mars 2025

- MARRËVESHJET DYPALËSHE PËR SIGURIMET SHOQËRORE

Në kuptim të këtyre marrëveshjeve,

Punëtor i dërguar - nëse një person që është i punësuar në territorin e njërit shtet kontraktues dërgohet përkohësisht në territorin e shtetit tjetër kontraktues nga punëdhënësi i tij me seli në një nga shtetet kontraktuese, *atëherë ky person vazhdon t'i nënshtrohet ekskluzivisht legjislacionit të sigurimeve shoqërore të vendit që e dërgoi*, si më poshtë:

- person i punësuar ose i vetëpunësuar
- person i punësuar në kompanitë e transportit rrugor
- person i punësuar në kompanitë e transportit detar
- person i punësuar në kompanitë e transportit ajror
- nëpunës civil
- diplomatët/konsujt

Kohëzgjatja është 24 muaj. Nëse kërkohet një shtyrje përtej 24 muajsh, autoriteti kompetent në vendin e dërgimit miraton vazhdimësinë e punësimit.

Zyra e ndërlidhjes, pasi merr “formularin e mbulimit” për punonjësin e postuar, njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Fondin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për sigurimet shëndetësore

- KODI I PUNËS

Në kuptim të këtij Kodi,

Agjencia e Punësimit të Përkohshëm - nënkupton punëdhënësin, i cili, në bazë të një kontrate pune, punëson një punëmarrës për të punuar përkohësisht në një ndërmarrje pritëse dhe që ushtron të drejtat e detyrimit e punëdhënësit bashkërisht me subjektin pritës¹.

Ndërmarrja pritëse - është çdo punëdhënësi, i cili punëson përkohësisht një punëmarrës, të vendosur nga Agjencia, dhe ushtron të drejtat e detyrimit e punëdhënësit bashkërisht me Agjencinë.

Punësim i përkohshëm nga Agjencia - do të konsiderohet periudha kur një punëmarrës kontraktohet nga Agjencia për t'u punësuar përkohësisht nga një ndërmarrje pritëse, me kusht që midis Agjencisë

¹ Kodi i Punës, Neni 18/1

dhe punëmarrësit të ketë një marrëdhënie kontraktore punësimi.²

Paga minimale - përcaktohet në bazë :

a. të faktorëve ekonomikë, kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe zvogëlimit të papunësisë, rritjes së prodhimit;

b. të nevojave të punëmarrësve dhe familjeve të tyre, duke pasur parasysh nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëmarrësve në vend, të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore dhe nivelet e jetesës së grupeve të ndryshme shoqërore³.

Paga - nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

- **LIGJI PËR TË HUAJT**

Në kuptim të këtij ligji,

“Punëdhënës” është personi fizik ose juridik, nën drejtimin e të cilit i huaji kryen një punë ose një shërbim kundrejt shpërblimit⁴.

Dispozita të tjera

Në kuptim të këtij ligji,

“Leje unike” është leja e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, që lejon shtetasin e huaj të qëndrojë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime pune.

“Miratimi për punësim” është autorizimi i lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për kategoritë, të cilat, sipas përcaktimeve në këtë ligj, marrin miratimin paraprak të agjencisë

“Leje qëndrimi” është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve

“Punësim i paligjshëm” është punësimi i një të huaji me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë.

“Qëndrim i parregullt” është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

² Kodi i Punës neni 18/1

³ Kodi i Punës, neni 111

⁴ Neni 3, pika 28 LH 79/2021

“Transportues” është personi fizik ose juridik, i regjistruar për ofrimin e shërbimit të transportit të personave.

“Leja unike (TBN)” lëshohet për qëllim të transferimit brenda ndërmarrjes së një të huaji⁵.

“Leja unike si punëtor stinor” i jepet të huajit në rast se plotëson kriteret për qëndrimin e përkohshëm, kriteret e posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji dhe pas miratimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive⁶.

“Profesionistë të pavarur” janë personat fizikë të angazhuar në ofrimin e një shërbimi, të cilët janë të regjistruar si të vetëpunësuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kanë një kontratë për ofrimin e shërbimeve me një përfitues në Republikën e Shqipërisë.

“Persona vulnerabël” janë të miturit e huaj, të miturit e pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, femra shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, si dhe persona, të cilët kanë qenë objekt i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunimeve të rënda psikologjike, fizike e seksuale, migrantët që për shkak të situatës së tyre specifike nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe janë në kushte veçanërisht delikate, si punëtorët e shtëpisë, migrantët me orientim seksual të caktuar, migrantët në gjendje shëndetësore të rëndë dhe ata me aftësi të kufizuara.

⁵ Neni për TBN, LH

⁶ Neni për lejen unike si punonjës stinor, LH